

PLAN VJETOR PËR PROCESIN E VENDIMARRJES (KONSULTIMIT PUBLIK) PËR VITIN 2020

Në përputhje me nenin 6 të Ligjit 146/2014, datë 30.10.2014, “Pë Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, është përgatitur plani vjetor për transparencën në procesin e vendimarrjes së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky plan përfshin informacion mbi veprimtarinë ligjore sipas përcaktimeve në ligjin 146/2014, datë 30.10.2014, “Pë Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Nr.	Titulli Proketligjit	Afati paraqitjes në KM	Qëllimi	Periodha konsultimit	Mënyra konsultimit publik
1.	“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve".	Katë mujori I, 2020	Ndryshimet e propozuara kanë qëllim heqjen e detyrimit për disa produkte për tu pajisur me certifikatë fitosanitare sipas ndryshimeve të Rregulloreve të BE dhe Komisionit, si dhe në kuadër të procesit të derregullimit.	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	1. Publikim në RENJK
2.	"Për një ndryshim në ligjin nr. 64/2012 date 31.05.2012 "Për peshkimin" i ndryshuar.	Katë mujori I, 2020	Ndryshimet e propozuara në nenin 30 të ligjit ekzistues nr.64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, kanë për qëllim kufizimin e numrit të anijeve të peshkimit artizanal bregdetar dhe i anijeve të peshkimit për peshqit dimersal, me qëllim rimëkëmbjen e rezervave për specitë demersale si të merlucit, barbunit, skampit dhe karkalecit të thellesisë por jo vetëm. Pra synojnë të mbyllin numrin e anijeve të peshkimit tregtar profesional.	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	1. Publikim në RENJK
3.	“Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”	Katër mujori II, 2020	Ky projektligj ka për qëllim zbatimin e qasjes së BE-së për zhvillimin rural me pjesëmarrje (qasja LEADER), nëpërmjet përcaktimit të parakushteve, për krijimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV) të cilët do të mundësojnë, përmes partneritetit lokal dhe metodës nga poshtë-lart, përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	1. Publikim në RENJK 2. Takime me grupet e interesit

			<p>dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti në varësi të nevojave të tyre, marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve të tyre financiare dhe menaxhimin e tyre bazuar në zhvillimin e qendrueshëm</p> <p>Ky projektligj përcakton parimet bazë, standardet, përgjegjësitë, dhe proceset për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit, dhe hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti, në harmoni me Politikën e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural</p>		
4.	“Për Vreshtarinë dhe Verën”	Katër mujori III 2020	<p>Ky projektligj ka për qëllim vendosjen e rregullave për prodhimin, për praktikën enologjike të autorizuara e kufizimet që zbatohen për prodhimin e përgatitjen për treg si dhe për emërtimin e origjinës, të treguesve gjeografikë dhe për termat tradicionale të rrushit, verës dhe produkteve të tjera të përftuara nga rrushi dhe vera.</p>	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	<p>1. Publikim në RENJK</p> <p>2. Takime me grupet e interesit</p>
5.	"Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve “ i ndryshuar.	Katër mujori III 2020	<p>Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë boshllëkun ligjor lidhur me prodhimin, grumbullimin, perpunimin dhe tregtimin e duhanit dhe cigareve.</p>	Sipas parashikimeve ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	<p>1. Publikim në RENJK</p> <p>2. Takime me grupet e interesit</p>